

EPPC Albania po kërkon për klientin e saj, një institucion financiar një **Oficer të Lartë Kredie**.

Përgjegjësitë kryesore:

- Analizon tregjet potencialë në mënyrë që të identifikojë nevoja të mundshme dhe zhvillon një plan kërkimor duke konsideruar profilin e duhur të klientit;
- U siguron shërbim të shpejtë dhe profesional klientëve potencialë dhe ekzistues duke ndërtuar marrëdhënie afatgjata;
- Identifikon klientë potencialë, individë ose biznese në nevojë për financim dhe negociacion me ata për financim ose ofron këshillim financiar;
- Inicion në mënyrë proaktive procesin e shitjes për të arritur objektivat e shitjes;
- Vlerëson risqet lidhur me aplikimin për kredi duke konsideruar karakterin e klientit, stabilitetin e biznesit dhe informacionin në sektorin përkatës;
- Analizon kapacitetet ripaguese të klientit dhe përcakton nëse kredia mund të përmbajë një risk të pranueshëm brenda udhëzimeve të politikave të kredisë;
- Kryen të gjithë kontrollet e nevojshme sipas procesit të kredidhënies mbi historikun e kredive të palëve dhe personave të lidhur si dhe dokumentacionit përkatës që është pjesë e propozimit për aprovim;
- Qëndron i përditësuar në lidhje me produktet, procedurat dhe politikat e reja, si dhe termat dhe kushtet e reja të propozuara nga Kompania;
- Performon mbledhjen e hershme dhe intensive të kredisë dhe ndjek vonesat sipas strategjisë së kompanisë me fokus normalizimin e pagesës së kredisë duke u përqendruar tek negociimi me klientin;
- Siguron trajnim dhe mentorim të përditshëm për Oficerët e rinj duke bërë të mundur integrimin më të shpejtë të tyre në institucion.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare e preferueshme në Financë, Administrim Biznesi ose në fusha të tjera të ngjashme;
- **E preferueshme minimalisht 3 vite eksperiencë pune në pozicione të ngjashme;**
- **Aftësi shumë të mira për të iniciuar, menaxhuar dhe zhvilluar marrëdhënie biznesi;**
- **Aftësi të mira analize financiare;**
- Profil i orientuar drejt objektivit.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.